



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE**

RELACION

PËR

**“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 5 TË MARRËVESHJES NR. 10216/1 PROT.
DT. 25.11.2022 NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A. PËR ZGJEDHJEN E
SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A SI AGJENT
TATIMOR”**

Midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A, është nënshkruar marrëveshja Nr. 10216/1 Prot dt. 25.11.2022 “Për zgjedhjen e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A. si agjent tatimor, për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore familjare të Bashkisë Korçë.

Në marrëveshje janë përcaktuar në mënyrë të ndërsjelltë të drejtat dhe detyrimet e palëve që do të lindin nga zbatimi i objektit të marrëveshjes.

Në pikën 5 të marrëveshjes është përcaktuar se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a. në rolin e agentit tatimor, përfiton 2% komision të llogaritur mbi shumën totale të taksave dhe tarifave vendore familjare që ka arkëtuar dhe rakorduar si dhe kalon në favor të Bashkisë 98% të shumës së arkëtuar:”

Me qëllim llogaritjen në mënyrë të saktë të shumës prej 2% komision, është e nevojshme që Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë të bëjë kalimin e 100% të shumës së arkëtuar nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore familjare, për llogari të Bashkisë Korçë dhe kjo e fundit të bëjë kalimin për llogari të shoqërisë, të komisionit në masën 2%, të llogaritur mbi shumën totale të taksave dhe tarifave vendore familjare të arkëtuara nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a.

Sa më sipër, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, nenin 9/1.3 pika b, 1.4, 1.6, 35, 54/ë/f. 64/c të Ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 5, 32/2 të Ligjit Nr. 9632 dt

30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjt Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i kërkohet Këshillit të Bashkisë Korçë, të miratojë, ndryshimin e pikës 5 të marrëveshjes Nr. 10216/1 prot. dt. 25.11.2022 nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë si më poshtë:

“Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a., në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore familjare, kalon në llogari të Bashkisë Korçë 100% të shumës së arkëtuar nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore familjare. Pas arkëtimit dhe rakordimit, Bashkia Korçë kalon në favor të shoqërisë 2% komision mbi shumën totale të arkëtuar, për shërbimin që kryen kjo shoqëri dhe me qëllim mbulimin e kostove të lidhura me këtë rol.

Drejtores e Përgjithshme: A. Qeramixhi (Dishnica)

Drejtor i DTTV: Soniel Prifti

KRYETAR I BASHKISË

Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/ VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . ____

PËR

“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 5 TË MARRËVESHJES NR. 10216/1 PROT. DT. 25.11.2022 NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A. PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A SI AGJENT TATIMOR”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, nenin 9/1.3 pika b, 1.4, 1.6, 35 54/ë/f, 64/c të Ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 5, 32/2 të Ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjt Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI

1.Të miratojë ndryshimin e pikës 5 të marrëveshjes Nr. 10216/1 prot. dt. 25.11.2022 nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë si më poshtë:

“Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a., në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore familjare, kalon në llogari të Bashkisë Korçë 100% të shumës së arkëtuar nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore familjare. Pas arkëtimit dhe rakordimit, Bashkia Korçë kalon në favor të shoqërisë 2% komision mbi shumën totale të arkëtuar, për shërbimin që kryen kjo shoqëri dhe me qëllim mbulimin e kostove të lidhura me këtë rol.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R

Erjon NEXHIPI

Miratuar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____